



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 7^{te} e Legjislacionit të VI^{te} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 29.06.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 13. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 14. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 15. Arben Kabashi, PDK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 16. Ajshe Metaj, PDK; |
| 5. Haki Podrimaj, LDK; | 17. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 6. Selajdin Bytyqi, LDK; | 18. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 7. Valbona Demaj, LDK; | 19. Arif Elshani, AE; |
| 8. Edona Lubeniqi, LDK; | 20. Radoš Repanović, SL; |
| 9. Naim Imeraj, AAK; | 21. Radenko Belošević, RB; |
| 10. Nexhmedin Balaj, AAK; | 22. Slaviša Maliković, SM. |
| 11. Muhamet Ukaj, AAK; | |
| 12. Eliot Kukiqi, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, Nënkryetari i Komunës z. Lulzim Blakaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2019-2021,
4. Raporti i punës së prokurimit për vitin 2017 dhe planifikimi për vitin 2018,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian, për vitin 2017 -2021,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rishikimi të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP "Stacioni i Autobusëve" në Istog

Kryesuesi – Hedhe në miratim këtë pikë të rendit të ditës:

Një zëri u vendos:

Miratohet një zëri

Shqyrtimi i pikës 1.

Në mbledhje munguan Luljeta Zeqiraj ka rast vdekje dhe Agron Avdiaj nga VV për shkaqe shëndetsore, si dhe tre anëtar që ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë petrifikuar anëtarët dhe ne jemi sot vetëm me 22 anëtar prezentë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi – vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutim në procesverbal, Kuvendi i Komunës vendosi:

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2019-2021, kemi pasur ko që ta analizojmë këtë rregullore kemi pasur dëgjimin publik.

Osmon Sadikaj, Zyrtar kryesor Financiar – përshëndet të gjithë të pranishmit dhe bënë prezantimin dhe sqarimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2019-2021.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë së këtu jo vetëm që ka hapësire për kritik por ka hapësire edhe për analizim përpos planifikimeve për vitin 2019 -2020-2021 e di se në mbledhjen e prillit Asambleja e ka aprovuar një ngritje të tarifave prej shërbimeve komunale dhe për rrjedhojë ngritja e këtyre tarifave është dashur që niveli i të hyrave të ketë planifikim pozitiv të me mbetur fiks i njëjti si në vitet e kaluara, pak ka pasur ulje nëse e marrim për bazë vitin 2014 dhe 2015. Për shembull martesat e lidhura jashtë vendit 2014- 2019 tjetër është 2017 -2021 është numri i njëjte i qytetarëve ku do të kërkojnë një shërbim të gj3ndjes civile dhe nëse kështu kish me ndodhur ngritja e tarifave për këto shërbime patjetër është dashur me e rrit edhe të hyrat për këtë kategori. Tek procesi buxhetor për vitin 2019 shpenzime në total të parapara janë mbi 10 milionë ndërsa investime kapitale në vitin 2019 janë planifikuar mbi 3 milionë. Të hyrat nga grandet qeveritare janë planifikuar mbi 9 milionë, të hyrat vetanake janë planifikuar mbi 1 milionë shumë që nuk korrespondon në totalin e të hyrave të planifikuara për vitin 2019 besoj që është gabim si barazim shuma e parave mbi 3 milionë nuk e di se ku keni me i parapare me buxhetin nuk figuron askund. Nuk e di me thënë se kryetari nuk është aspak fajtor për këtë katrahurë financiare besojë se janë drejtoret e drejtoreve që e pranojnë projekt propozimin e pa ushale dhe personat përgjegjës të përpilimit të këtij dokumenti kisha propozuar me marr e me shikuar vet kornizën Afatmesme buxhetore, se kurë ta shihni një lëmsh që është një katrahurë e vërtet unë personalisht kisha qenë i interesuar ti marr përgjigjet e sakta dhe konkret nga drejtoret përkatës. Propozon prej 28 fshatrave kam marrë propozimet në bashkëpunim me strukturuar ka janë të PDK-së secili mirë ka pru jam i obliguar me i thënë ato propozime, ka prej tyre edhe që janë të planifikuara por shumica janë që nuk janë të planifikuara,

Propozon një pilotë projekt që ka të bëjë me punësimin e qytetarëve për komunën me efekt direkt për zhvillimin ekonomik në komunën tonë, ideja është që përmes investimit publike privat Komuna të marr masat e duhura për me i arsyet mundësit e njëjta për njërën nga bashkësitë lokale të komunës ku kisha dashur të jetë në Gurrakoc me qënëse është qendër urbane pak edhe është urë lidhëse me komunat tjera dhe meqenëse është pilot projekt ndërtimi i një mini fabrikë ku kishin me u punësuar minimumi 15 deri 25 persona ku të gjithë të punësuarit do të participonin me shumën 1500 euro ku kjo shumë do të përbënte 50% të aksioneve ku aksionar do të jenë vetë të punësuarit aty dhe pjesë e këtij planifikimi të jetë komuna ka plotë ide për projekte sidomos në sektorin e bujqësisë ku disa prej të cilave kishte me qenë përpunimi i materialeve në tekstil, përpunimi i konservime të produkteve dhe kështu ngjashëm e ki shembullin në Krushë në Prizren kemi disa mini Fabrika ku ju ndihmon komuna dhe vetëpunësohen, ky propozim është që në të ardhmen të jetë si festë për vitet vijuese që të mundësoj kushte punësimi. Propozimet, në fshatin Sine është shpallur zonë ekonomike por nuk ka as ndriçim as kanalizim as kubizmi nuk ka gjëra elementare që me mund me i thith investimet nga donatorët qoftë të brendshëm apo të jashtëm propozon që këto të mundësohen nga drejtorit përkatëse mundësia e financimit është direkt e drejtorive përkatëse. Propozon këto projekte në fshatin Sine, Kanalizimi, Kubizmi i trotuarit dhe ndriçimi, fshatin Shushic e Ulet asfaltimi i rrugës lagja "Nimon Sadriaj" dhe ndërtimi i urës afër shkollës, në fshatin Studenicë ndërtimi i Shtepis së Kultures, ndërtimi i sallës së sportit në lagjen "Fidanishte" dhe ndërtimi i Rrugës në Lagja "Sefaj" Ndërtimi i një sheshi në qendër të Istogut, vazhdimi i projektit në lumin "Qaushi" Istog, Shenjezimi i asfaltit me vija të bardha të ndërprera ka shkolla e mesme "Haxhi Zeka" dhe ka shkolla fillore "Bajram Curri" Istog Rregullimi i shtratit të lumit në lagjen "Hajzeraj" të ish

Standardi 50 metra, Renovimi i tregut, Istog, Istog i poshtëm asfaltimi i rrugës lagja "Dekaj" 300 m. Në Gurrakoc qendra rinore të rinovohet dhe të funksionalizohet, Asfaltimi i rrugëve "Smajl Metaj", "Smajl Kabashi", "Daut Bajramaj" dhe "Gjafer Mehmetaj" Kovragë kubezimi i trotuarit dhe ndriçimi publik, dhe kubezimi afër shkollës fillore Kovragë – Veriq, lagja Haxhijaj asfaltimi i rrugës, Kovragë. Tomoc asfaltimi i dy rrugëve që kanë mbetur lagja "Iubeniqi" dhe rruga "Kushtrimi" Mujstir kanalizimi Banjë asfaltimi i rrugëve "Regjep Podrimaj", Xhemajl Camaj" dhe "Regjep Maksutaj" Cerkoz asfaltimi i rrugës.

Naim Imeraj, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, qasja analitike e kolegut Arben dhe prej fillimit duhet ta kuptojmë që jemi një fazë planifikues dhe krejt ato gjëra që janë thënë e që ekzistojnë aktualisht që mund të ndodh që ndonjëherë me i përsëritur gjërat e ekzistojnë por prape se prape janë materie të cilat në fazat planifikues duhet me u përfshirë më KABK nuk do të jem në përpjekje që të kontribuojë në këtë rend ditë aq analitik për çka e përgëzoj kolegun Arben po do të përpiqet të merrem me anën përmbajtësore në aspektin e disa gjërave, KAB- i tek unë personalitete versionin e KAB-it dhe një dokument Exel me emërtimin tabela2 të datës 14.06.2018 kanë një mospërputhje, të fajlli i KAB-it kemi një diferencë prej 250 mijë euro të një projekt i cili në na ka ardhur një fajll Exel që ka të bëjë konkretisht me arsimin para fillor dhe konkretisht me projektin ndërtimi i objektit të ri kopshti i fëmijëve gëzimi ynë që në versionin e Exel të datës 14.06.2018 është 300 mijë euro ndërsa të KAB- i është 50 mijë euro cili është versionin e duhur ekziston një diferencë prej 250 minë eurove nga KAB-i dhe tabela e Exel. Të KAB-i është të figura dy të shpenzimet ekonomike 2019- 2021 është përsëritur i njëjti fajllë me komplet të njëjtat vlera që realisht nuk besoj që është e arsyeshme për faktin që kur e shikoj tabelën e të hyrave vetanake nuk janë të njëjta tabelat automatikisht del që është bërë kopi past 2019 të 2020 dhe të 2021 nuk kisha pasur dëshirë që një material i tillë të shkoj në ministrin e financave, ta trajtojmë si gabim teknik se në planifikimin për vitin 2018 me tendencat e para planifikuara.

Të hyrat vetanake bënë vërejtje thotë se nuk është vërejtja e këtij viti por edhe viteve të kaluara se nuk kanë bërë përpjekje për me bë planifikim të mirëfilltë të të hyrave vetanake shtimi i planifikim për 9,4% diferenca është shpërndara në dy nen programe ekonomike. Ky lloj i planifikimit nuk është planifikim i cili ka pasur bazë janë i vetëdijshëm që viti e kaluar ka pasur problem me të hyrat vetanake të viti 2017 por ajo nuk ish dashur të jetë tendencë që ne me bë një planifikim i cili nuk i ndërron shifrat absolut përpos këtyre dy pozicioneve që pozicioni i dytë është tatimi në tokë dhe mbledhja e burgjeve ky emërtim i këtij programi në çka asoconë, a është taksa e cila planifikohet që të futet si obligim ndaj qytetarëve në vitin 2019 se nuk ka qenë si e tillë. Po shpresoj që tendenca është që planifikimi për 2018 të përmbushet dhe mos të kemi probleme të theksuara me planifikimin që e kemi parapa për vitin 2019. kish qenë mirë me u sqarua këto shqetësime që i kam lidhur me të hyrat vetanake.

Zyrtari kryesor financiar e ceku se në procesin e planifikimit sa i përket listës së projekteve kapitale kanë qenë të definuar shumat për programin sipas programit, por ndodh që paraqiten nëpër në programe duhet ta keni parasysh nuk e di që është e logjikshme që të njëjtin në dy programe ekonomike të jetë një projekt i njëjte me emërtim të njëjte, ka projekte të përsëritur ka dy herë nëpër programe. Rregullimi i pronave komunale nuk e di sa kanë të bëjnë me atë vërejtjen e përgjithshme që jepe auditori i jashtëm.

Zhvillimi Ekonomik për vitin 2019 ekzistojnë katër buxhete të paraparë por nuk ka projekt sigurisht është gabim teknik. Projekti më konsulentë për rrugë dhe trotuare në Istog me buxhet zero ndërsa janë parapare për ndërtim dhe rregullim të trotuareve dhe rrugëve në Istog janë paraparë buxhet a është krye faza e projektimit apo ndoshta nuk është e nevojshme kjo përsëritur edhe për Luna Parkun, kjo përsëritet për ndërtimin e sheshit qendror që fatkeqësisht nuk kanë buxhet. Të sqarohet çështja e konkursit me konsulence çka realisht nënkupton ka dyfishim edhe brenda një Drejtoria shëndetësia ka dy herë mirëmbajtjen të objekteve shëndetësore etj, të filtrohen këto. Dhe së fundi në misionin i cili cekët në pjesën tekstuale të KAB-it një ndër pikat është edhe furnizimi me ujë i qytetarëve të Istogut si synim strategjik. Në këtë listë të projekteve nuk pash as një ujësjellës. Pyetën cilën fazë jemi për realizimin e ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijes për fshatrat e mivades, e di se në këtë kuvend kemi kaluar një kredi dhe nuk e di fati i asaj kredie ku është. Pse nuk ekziston ndërtimi i kanalizimit për ujin e pikës për regionin e mivadës. Dy shkollat e Uçës dhe e Llukarit të Begut që se paku janë të planifikuara tek burimet e tjera të planifikimit.

Arif Elshani, IQ - përshëndet të gjithë të pranishmit, në kemi një KAB të njëjte me vitet e kaluara që planifikimi shkon në disa zona të caktuara, planifikimi duhet të respektohet sipas nevojave banorëve kilometrat katror që shfrytëzohen komunën tonë planifikimet janë të pa drejta edhe kjo kornizë vjen si përfundimtare ju e dini se propozimet tona nuk kalohen disa herë janë qit në letër por nuk janë realizuar me qëllim ai pa qëllim nuk e si. Sa unë shohë këtu me se tepërmi lihet masë dorë fshati Saradran ku në vitin 2014 në të gjithë kemi qu gishtat dhe e kemi bërë një qendër urbane, dhe sot Saradran i nuk ka kubëza nuk ka qendër Rinore nuk ka ndriçim e vërtete që vitin e kaluar komuna atje shumë pak i ka dhënë rëndësi. Problemi kryesor është që në Banjë nuk ka ujë të prijëse si të fillon marsi e deri në tetor nuk ka ujë disa herë kemi kërkuar këtë por këtu nuk e shohë këtë planifikim as nga burimet tjera banja duhet një herë e përgjithmonë të këtë këtë propozim, mendoj që kjo kornizë mundësisht bëhet nga zyrat. As një herë nuk kam parë që janë hy propozimet e anëtarëve të Kuvendit dhe nuk e shohë të rrugës të propozoj. Kemi mirëmbajtjen e varrezave të Saradranit, kubëzimi në 2020 nëse vinë parët ky planifikim as një here nuk është realizuar sipas këtyre statistikave që kemi dhënë e shumë që njëjte shkon me drejtorit e bujqësisë. E për gëzoj Lulin çka ka parë në drejtorit me i menaxhua nëse ja lajnë të shohim 190 mijë euro janë planifikua nga planifikimet tjera ato djalë të sigurt, unë mendoj për këto që unë po i them ka mundur komuna me w nda një pjesë të buxhetit nga burimet e sigurt dhe mandej me i kërkuar burimet tjera në kemi shumë burime që janë paraqitur disa herë por as një herë nuk janë realizuar kemi ndërtimi i disa rrugëve në Saradran 40 mijë euro janë shumë. Pak për fshatin Saradran 40 mijë euro për rrugë ndoshta këto 40 minë euro me i qit për ndriçim pasi që kemi fëmije që udhëtojnë, as s'ka rrugë as kubezimi as ndriçim, ende nuk kemi pasur ndonjë rrezik por rreziku vjen çdo herë. Ndërtimi i parkut në ish radusha a është kthyer pronësia e këtij parku në pronësi komunale.

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, përgjigjet pyetjes, ende nuk është kthyer ish radusha në pronë komunale, lenden e kamë dërguar komplet në zyrën e kryeministrit dhe në agjension kamë premtime që do ta realizohet dhe po presë përgjigje.

Arif Elshani, IQ – thotë që mendon si ekonomisë në biznesin e tij investime në pronën e huaj 400 mijë euro, për mu janë te pabazë, ne 2014 është bisedu këtu, është hap tema se si të kthehet radusha, ju e dini shume mire ne tri mënyra qysh kthehet te cilat nuk po i përmendi, po janë dy mënyra qysh kthehet prona ato veprime, marrë për 4 vite. Investimet 400 mijë euro unë si anëtar i kuvendit them se janë të gabueshme po sidoqoftë ju jeni ata që vendosni.

Kryetari i Komunës- Arif ti ma bane një pyetje unë përgjigjen ta dhashë, po te ishte pronë komunale kjo do te ishte e kryer, po meqenëse nuk është pronë e komunës nuk jemi duke investuar aty.

Arif Elshani, IQ – Është e gabueshme planifikimi 400 mijë euro ne piken e pare ne qoftë se nuk është pronë komunale.

Kryetari i Komunës – Aty nuk do te behet asnjë investim deri sa prona te kthehet ne pronë komunale.

Arif Elshani, IQ- Dy gjera ne mërqinjën jetësore Arsimi dhe Shëndetsia dhe ne këto i leme me se poshti, ma shume investojmë ne bjeshkë se sa ne këto dy fusha. nuk do te lëshona ne shumë vërejte qe kemi por i kemi edhe dy shkolla qe shumë here i flasim, zotëri kryetar prej burimeve tjera i ke parapa 700 mijë dhe 400 mijë, qe 4 vite ne flasim pse si ke nda ka 100 mijë edhe me e nise punën. Ndoshta kish qen shume ma mire për te ardhur deri tek finalizimi i tyre. Ky planifikim për mua nuk është i drejt, kjo kornizë afatmesme është e papranueshme, joprofesionale dhe nuk është në te mirën e qytetarëve të komunës së Istogut.

Ajshe Metaj, PDK- Përhëndet të gjithë të pranishmit ku thekson se e kanë analizuar këtë program mirëpo nuk do te shkojmë hap pas hapi për analizë pasi qe këta hapa i kemi kaluar ne komitet për politikë dhe financa, mirëpo nga këto projekt propozime që janë parapa në kornizën 2019-2021 kam për ti propozon edhe disa propozime në qoftë se janë me vend dhe zen vend këtu. Një prej tyre është rrethimi i përmendores më fshatin Kamenice, arsyeja e rrethimit është pozicioni i kësaj përmendorja te cilën e dimë të gjithë se ku është, e cila frekuentohet nga kafshët dhe çdo gjë tjetër qe bije andej, si dhe ndërtimi e rrugëve ne Kamenice për te cilat kisha propozu qe të hynë ne kuadrin e këtyre projekteve që janë këtu. Sa i përket sektorit prej fushës prej të cilës vij unë kërkoj pasurimin e bibliotekës se shkollës përpos me lektyra edhe me tituj shkencor nëse ka mundësi meqenëse është Gjimnaz dhe është burim burim ku vijën të gjitha kuadrat që thirrem prej tyre këtu. Dua të parashtroj edhe një pyetje rreth rregullimit te infrastrukturës së jashtme të Xhimnazit “Haxhi Zeka”, është përmend rrethoja, për çfar rrethoja bëhet fjalë?

Sa i përket ndarjes së buxhetit për barazi gjinore i kom edhe aty nuk kam shumë fjale edhe aty konkrete i kam. Ne qofte se nuk jam gabim 22. diqka % shkon për barazi gjinore, këtë vit pak a shumë jam ne rrjedha sepse me herët nuk isha në rrjedha politike. Nga se përfaqësoj interesin e të gjithë qytetarëve, ne fakt edhe të barazisë gjinore a është nda edhe viteve të mëparshme buxheti për barazi gjinore, a është konkretizu ndonjë projekt ose çfarë projekteve ka aty edhe ne interes kujt kanë shkua?

Osmon Sadikaj, zyrtar kryesor financiar, sa i përket ligjit për mundësi të barabarta gjinore në bazë të këtij ligji dhe në bazë të barabarta qarkores buxhetore nuk duhet të jetë buxhet i veçante për meshkuj dhe për femra por duhet të jetë një dhe të gjitha këto projekte duhet që paraprakisht të bëhet një analizë sa përfitojnë meshkujt e sa femrat e jo të ndajmë buxhet për femra dhe të ndajmë buxhet për meshkuj.

Ajshe Metaj, PDK – barazia gjinore nuk shkon vetëm nga njëra gjini por përfshihet nga të dy gjinitë.

Naim Imeraj, AAK – është një paqartësi nëse është formuar grupi jo formal i grave asamblistë që është një planë i veprimt një plan i punës , profesoresha e ka fjalën të çështja e financimit të prioritetëve në atë planë. Po besojë se ajo shkon nga mallrat dhe shërbimet nuk ka të bëj me shërbime kapitale.

Mirushe Sadikaj, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, sa i përket KAB-it nuk ka ndonjë ndryshim në të gjitha periudhat kohore, nuk ka as një rritje të te hyrave edhe pse ka rritje të tarifave, ka rënjë të te hyrave të pronës publike. Projektet kapitale secilit projekte të cilat janë përfshirë në KAB kanë rendësi mirëpo janë disa projektet që kanë rendësi me të madhe dhe janë proritët, filloj me disa kërkesa të cilat janë kërkesa të mëhershme e mirë po disa projekte të cilat kanë qenë projekte të planifikuara të viteve të mëparshme ku shtyhen nga viti në vite propozon: ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kaliqan, dhe Orroberd, Ndërtimi i trotuarit nga Vrella në Studenic deri të shkolla fillore në Studenic dhe policat e shtrirë afër shkollës, ndërtimi i rrugës “Shaban Sadikaj”. Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Studenicë. Propozon që për regjistrimin e nxënësve të vihen kritere që mos të jenë në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog mos të jem mbi 25 nxënëse, ka rendësi dhe ka nevojë për projektimin në shkollën e mesme teknike në Gurrakoc që të ketë suksese kërkoj që se paku 10 projektorë janë disa por nuk janë në gjendje të mirë ata po ashtu kisha kërkuar pasi.

Ardita Idrizaj, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, në KPF kamë propozuar rregullimin e rrugës në fshatin Lubozhdë në lagjen Idrizaj kamë propozuar të funksionalizohet kanali për ujitjen e tokave por në rekomandim nuk e pash as njërën.

Naim Behlulaj, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, më shumë dëshiron të kyqet në kërkesat e qytetarëve sepse këtu jemi për kërkesat e qytetareve janë disa kërkesa kryesisht nga fshatrat e mivadesë disa nga të cilat janë përfshira dhe disa nuk janë përfshirë, ne e dimi se çështja e ujësjellësit është çështje e kryere nuk e pash që figuron pore në bazë të do premtimeve është çështje e kryere ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat e mivades, ndërtimi i shkollës fillore në fsh. Uçë, kubezimi i rrugëve në fshatin Uçë lagja “Sali Islamaj” shkollë, ndërtimi i rrugës “Ramë Aliaj” , “Ramë Belulaj” , dhe lagjet Imerraj e Haxhiaj ndërtimi i rrugëve. betonimi i kanalizimit në Uçë, qendra rinore në fshatin Uçë, ndërtimi i rrugës “Ram Muzliaj”Ndërtimi i Ambullantes, asfaltimi i rrugës lagja Imeraj Padalishta, Asfaltimi në lagjen Fetahaj Padalishta.

Muhamet Ukaj, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, Propozon që në fshatin Kaliqan të ndërtohet kanalizimi, a ka projekt të veçanta që unë mund të jua dërgoj banoreve të fshatit, ashtu siç pyeti edhe zonja Mirushë edhe unë pyesë pse nuk ka vija

buxhetore për vitin 2019 dhe 2020 për fshatin Kaliqan. Është përfshirë një rrugë aty të lagja Metaj dhe Ukaj në shumë prej 20 mijë euro po pa kanalizim nuk na vjen asgjë sepse duhet të prishen për dite ato dhe në fund si propozim kërkon që në mbledhjen e ardhshme si rend ditë të kërkohet një komision i cili do ta vërtetoj gjendjen e përroit të fshatit Kaliqan sepse muajin gusht dhe shtator kurë temperaturat janë shumë të larta në jemi në rrezik prej ndonjë epidemie prandaj kërkoj që nga të gjithë të pranishmit të merret me më seriozitet kjo punë sepse jemi para një katastrofe, nëse dikush nga ju vjen asajë do ta vërtetoj se në çfarë gjendje është. Gjatë fushatave zgjedhore jo vetëm nga partia në pushtet por nga të gjitha partitë tjera na u është premtuar që për një afat shumë të shkurtër rruga që në e quajmë përroi i lugut të butë që kryetari ka qenë dhe i ka parë ato aty na u është premtuar se do të përfundojë në muajin e parë pas zgjedhjeve aty të gjithë qytetarët që enden andej shkelin në kimikate që derdhen nga kanalizimet, andaj është momenti i fundit që diçka të ndërmerret në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës - i dëgjova të gjitha propozimet dhe kjo mbledhje është për të dhënë propozime, të mblidhen të gjitha këto propozime t'i trajtojmë dhe cili projekt është më me prioritet ta miratojë. Janë disa kufij preliminar ato gabime teknike që i përmendi Naimi me shumë kujdes të cilat duhet të përpunohen me mirë se vërehen ato gabime. Asnjëherë personalisht edhe në periudhën si kryeshef ekzekutiv dhe si kryetar komune nuk kam qenë i kënaqur në tersi me planifikimin, planifikimi është një lloj shkencë për mu ne shpeshherë bim në ndikime të propozimeve që na vijnë nga vetë qytetarët qoftë për garë elektorale apo diçka tjetër ne ende nuk jemi të përgatitur si shoqëri që me pas ekzakt një strategji. Planifikimet janë të zorshme shpeshherë dalin edhe të pa realizueshme. Një sugjerim i mirë nga Arif Elshani nëse në fshatin Saradran janë planifikuar 40 mijë euro duhet të mendohet se për çka ka më shumë nevojë fshati a për ndriçim, për kubëzim apo për rrugë duhet të rregullohet çka ka nevojë me shumë. Jemi duke ardhur në fazën përfundimtare të ndërtimit të rrugëve nuk mund të bëjmë rrugë në secilën qoshe, në duhet të rrisim fonde tani për mirëmbajtjen e këtyre rrugëve ekzistuese, nëse zgjerojmë ndriçim duhet me bë planifikimin e mjeteve për me mbajt ndriçimin me pagu rrymën.

Nëse nuk fitojmë grande nga qeveria investimet kapitale do të na zvogëlohen. Ne e kemi pasur këtë vit mbi 2 milionë nga burimet e sigurta tash parashihej mbi 3 milionë po shkojmë duke ardhur në një fazë të re të zhvillimit, ndërsa disa projekte që u përmenden për punësime është tjetër mision aty që behet ne ju dhamë disa bizneseve grande subvencione në mënyrë që bizneset e vogla ti shtypi sa ma shumë në zhvillim.

Çështja e ujësjellësit në fshatrat e mivadës para një muaji qeveria e ka miratuar kredinë janë edhe disa çështje ligjore se a do të shkoj në Kuvendin e Kosovës apo në zyrën e Presidentit të shtetit që ta firmosin jam në kontakt me ministrin e financave dhe me zyrën e Kryeministrit në mënyrë të vazhdueshme për këtë çështje dhe shumë shpejt pritet të finalizohet kjo janë tri komuna kanë fituar këtë, është një punë e madhe që është bërë për tri vite, dhe menjëherë pas finalizimit të kësaj punët mund të fillojnë me projektin e ujësjellësit.

Kanalizimi në Kaliqan projekti është i punuar në detal është projekt teknik nuk përfshihet vetëm Kaliqanin aty është i paraparë Kaliqani, Sudenica, Kamenica dhe është një pjesë në Orrobërdë duke u bazuar në disa shpërblime që i ka marrë komuna vitin e kaluar qoftë

për transparencë qoftë disa tjera dhe pjesën e parë Kaliqanin e kemi dërgua në hapësirë deri të shkolla, përgjigja është pozitive por ende nuk e kanë nënshkruar.

Sheshi në qendrën e Istogut është ide e mirë ne të gjithë në fushat e kemi përmendur sheshin para disa ditësh pjesa e sheshit Memoriali është nënshkruar marrëveshja para dy ditësh 200 mijë euro janë ndarë nga qeveria për mirëmbajtjen e monumenteve komuna do ta menaxhoj dhe brenda tri apo katër ditësh del në tenderim jemi duke punuar shumë rreth materialit që të mos ketë ndonjë lëshim apo gabim, sheshi do të jetë gjithsesi por aj projekt sipas disa parallogarive kushton përafërsia një milion e gjysme sepse duhet të ndërrohet infrastruktura komplet sheshi nga qendra deri të lumi poshtë kjo është pjesa që është paraparë për shesh. Istogu do ta ketë sheshin duhet ta ketë edhe parkun.

U përmenden shumë projekte, edhe Arbeni që me vjen mirë nuk u bë lokalist por përmendi të gjitha fshatrat. Çdo propozim jam i gatshëm ta pranoj nuk do të jem refuzuese se nuk kam qenë asnjëherë projektet as një herë nuk janë orientuar politikisht. Të gjitha këto projekte do të trajtohen, le të vine edhe qytetarët të propozoj projekte, këto projekte po jepen të njëjtat nga të gjitha patrit këtu, kemi shkollat çështja e shkollës së Uçës ajo me sa e di ka hyrë në projekt për vitin e ardhshëm, ndërsa Llukafci nuk po i plotëson kriteret për nga kuota numri i nxënësve për me u financuar nga Ministria e Arsimit sa e di pragu është në 230 nxënës aty është ra, duhet me bë diçka nga burimet tjera teknikisht me e rinovuar me e ndërru kulmin dyert dhe dritaret komplet me rinovuar dhe me bë një aneks ku është pjesa e tualeteve pastaj një fushë sportive që të shfrytëzohet për shkollë kjo është ideja e financimit se ndryshe nuk mundemi. Tani jemi në përfundim të projekteve dy vjeçare që kanë qenë është fshati Saradran disa rrugë nëpër fashat.

Jehonë Haxhiaj, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete kurë do të fillohet me realizim e ujësjellësit për fshatrat e mivadës, kryetari e dha një përgjigje por mund ta quajmë përgjigje të mangëte, çka të ju thuhet banorëve të fshatrave një datë konkretë.

Kryetari i Komunës - me siguri të plot po e thotë qeveria e ka miratuar ju dhashë dhe dy adresa të mundshme se ku mund të jetë ose në parlament ose të kryeministri është çështje e procedurave ligjore.

Arif Elshani, IQ - kryetari tha buxheti është shkencë, desha t'i them që ti vet me u ul për një ditë vet i dyti e bënë atë planifikim me të mirë se si është tu u bë se kaq vite. Dihet planifikimi si është kur ti e ki thanë në këtë kuvend para disa vitesh ma përpara e dërgoj të partia jem se të tjerët, por mendoj një gjë që të gjithë qytetarët e Istogut kanë të drejt në investime kapitale në mënyre të barabarta por bëni si të doni se po mundeni me bë.

Haki Podrimja, LDK - Përshëndeti të gjithë të pranishmit, Arbeni japi disa propozime dhe pata një sqarim për Banjë pasi që vi prej atij vendi Rruga Regjep Podrimja është në fazën finale të te ndërtimit prandaj si propozim lë të hiqet.

Enver Rugova, drejtor për shërbime publike - përshëndet të gjithë të pranishmit, është faza e dytë e të kubëzimit të trotuareve Gurrakoc- Zallqë janë të paraparë 40 mijë euro, është i paraparë projekt në faza mjetet janë ndarë për vitin e ardhshëm.

Nexhmedin Balaj, AAK – me shkollën fillore “Fan Noli” çka do të bëhet?

Kryetari i Komunës - të nxirrte projekti dhe sa bëhet do ta rregullojmë nga financimi i Komunës me burime tjera të bëhet një shkollë komode me hapësira të mjaftueshme

Eliot Kukiqi, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, një gabim të rekomandimet e KPF-së shkrinë të ndahen mjet për zyrën e veteranëve të luftës, ndërsa unë kam kërkuar subvencionet për zyre të veteran.

Kryesuesi - patëm një debati të mirë dhe të sinqertë prandaj duke e ditur se është Korniza afatmesme Buxhet orë nga ku edhe buron buxheti, të gjitha propozimet do të hynë në këtë kornizë

Naim Imeraj, AAK - kemi bërë një punë produktive sot vetëm kisha apeluar të ekzekutivi që këto projekte që u përmenden dhe që kanë me të vërtet një arsyeshmeri mos të jen të evidentuara vetëm si projekte por të shikohet mundësia të përkrahen ato që kanë arsyeshmeri dhe prioritet edhe me fondet financiare se realisht nuk po bëjmë asgjë po bëjmë një pranim të listës që në fundit po stërkequr dhe në prape po e zgjerojmë nuk është mirë që projektet e vitit të kaluar mos të figurojnë në këtë propozim të KAB-it po ta kemi një ide që kjo punë ka qenë produktive edhe në aspektin e asaj që është esenciale në aspektin e asaj që është jo vetëm në përmbushjen e dëshirave tona që me figuru dikund edhe me thënë që është hi në buxhet të hy në buxhet ajo që ka parë.

Kryetari i Komunës - keni të drejt Naim por sa e pash 80% pajtohemi me këto projekte që u propozuan këtu, propozimet 70% kenë të njëjta prej të gjithë anëtareve.

Hedhë në miratim piken e rendit të ditës:

Kuvendi i Komunës me 17 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime vendosi:

Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2019-2021.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditës, Raporti i punës së prokurimit për vitin 2017 dhe planifikimi për vitin 2018,

Zize Bujupaj, udhëheqës e zyrës së Prokurorit - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raporti të punës së prokurimit për vitin 2017 dhe planifikimi për vitin 2018.

Arif Elshani, IQ - Kam propozuar dhe të gjithë kolegët me kanë mbështetur që të jetë ky raport sot këtu që të jemi të njoftuar të gjithë anëtarët e Kuvendit se çka po ngjan me para tonë publike. Në muajin e 4 të këtij viti kam bërë një kërkesë nga Kuvendi Komunal pikërisht raportin e kontratave të nënshkruara për vitin 2017, shefja e zyrës së prokurimit ma kthen një letër që me hi me lexuesin nuk e di as unë dhe me siguri as ajo çka ka dashtë me thanë por e

ka dhënë një letër si përgjegjës por thonë që ajo është në webfaqe kontratat e nënshkruara për vitin 2017 nuk janë në web faqe e komunës në as një moment por në web faqe kemi planifikimet përfundimtare të prokurimit për vitin 2017. Kam disa pyetje për kryetarin pasi që është menaxher i komunës i mbikëqyr të gjithë zyrtarë tjerë që janë. Në kemi një zyrë të prokurimit që punon sipas dëshirës së vet mendojë edhe në raportin e auditimi është e njëjta vërejtje nuk ndermirët as një masë aty dhe aj person ajo drejtoreshë është e fuqishme nuk ka kush çka mi bë. E kam një kontratë të nënshkruar të vitit të kaluar me 19.07.2017 implementimi i lokacioneve turistike janë 87 mijë euro, këtë kontrata e kam marr nga burimet tjera që ka më mundësi si anëtar i Kuvendit në KPRPP e lyp një kontratë të tillë dhe ata ta dhëne kemi një kompani të famshëm që merr 73 mijë euro nga kryetari dhe nga drejtori që të na tregoj. Për 87 mijë euro në bjeshkë është një kompani që bënë projekte në bjeshkë, çka është punuar. Në zyrën e Prokurimit nuk ka transparencë aty punohet vetëm sipas ideve dhe dëshirave. Ndërtimi i kanalizimit në Kashicë është lagja Shoshi nuk janë shumë 12 mijë euro, nuk kam parë diçka që është ndërtuar në vitet e kaluara në Kashicë kisha pasur dëshira se çka është punuar me 12 mijë euro. Prigodë një kanalizim që janë paraparë 96 mijë euro është një kompani që ka marrë mbi 17 mijë çka është bërë me atë ujitje a është ndërprerë apo çka ka ndodhur. Planifikimet të projektet edhe sivjet janë 70 mijë euro duhet me ja dhënë kompanisë së njëjte, mendoj se këto 70 mijë euro gjysme me i nda për Stacion të Autobusëve. Kompania e njëjte po i fiton të gjitha janë shumë të gjitha projektet një kompanie. Kemi mirëmbajtja mobilieve 19 mijë euro vite për vit, kemi hapjen e rrugëve neper bjeshkë, ndërsa në fshatra kemi probleme me ujë e me kanalizime. Memoriali Ibrahim Rugova në 2014 janë shku për afërsisht 600 mijë tani 350 mijë me intereson çka ka ngjarje në kontratat e kaluara a kanë kryer punë çka ka ngjallur me kontratat që janë prish deri ku kanë kreu jo vetëm mi dhen 350 mijë euro pa as një sqarim keqpërdorimet me të mëdha që i shohë në 5 vitet e fundit janë për Memorialin Ibrahim Rugova është turp që një vend i shejt me u bë gjithë ato keqpërdorime. Hartimi i projektuar në shtëpinë e shëndetit 20 mijë dhe 70 mijë ka pasur zyra e prokurimit nuk ka transparencë është një njeri që bënë çka donë vetë, duhet të mendojmë se këto janë para të te gjithëve dhe nuk duhet të manipulohet me njërën e qytetarit . Drejtoritë me i korruptuar është Prokurimin qëndrojnë pranë fjalës sime deri sa të jem këtu.

Arben Kabashi, PDK - raporti për kontratë është veç një pjesa e raportit të punës së zyrës së prokurimit dhe si i tillë ka aspekte në të që të bien në sy, edhe komuna edhe qeveria i ka mbetur operatorëve ekonomik që i kanë krye punët bëhet fjalë për shuma të mëdha nëse i marrim për bazë shifrat të diskutimi i KAB-it mendoj që jemi në një situatë jo të mirë financiare për shkak të borgjeze, me mirë kish qenë e paraparë projekte me financim derisa të paguhen borxhet se sa më u fellu hala ma shumë gjendjen. Ka operator ekonomik që kanë marr tendera në shuma milionshe jo ka një herë e dy po ka aty edhe ka 10 herë edhe ka 15 herë nuk jam kundër askujt por nuk dua të lëshohem në këto nivele edhe komuna duhet ta bëjnë me strikt menaxhimin për implementimin e projekteve të operatorët ekonomik ka plotë raste të kalimit të periudhën te paraparë të zbatuar, po mendoj

që ky diskutim kish marr formë me të mirë në asamble ta kemi edhe raportin e punës së prokurimit jo tabelën e kontratave të nënshkruara.

Muhamet Ukaj, AAK - kam një krekës në çështjen e arsimit jo nivelin lokal por në përgjithësi nuk e di si shkonë proceduar në zyrën e prokurimit kemi probleme për letër për ngjyra për fotokopje a ka mundësi mos me i prit procedurat por me shku në mënyre ma të shpejt shpallja e tenderit këto ndërmarrje të cilat na furnizojnë në mënyre që ne të mos jemi tash e 7 muaj nuk kemi mundësi me marr asgjë aty ku kemi shku përpara, kjo mungesë është në të gjitha shkollat në nivel komune.

Ajshe Metaj, PDK - në gjimnazin Haxhi Zeka në Istog dua të di këtë projekt të viti 2017 ndërtimi i rrethojë së gjimnazit Haxhi Zeka në Istog për cilën rrethoj bëhet fjalë edhe disa projekte tjera ndërtimi i shtëpive të pa strehëve sa shtëpi janë ndërtuar cilin lokalitet, transportimi i punëtorve shëndetësor jasht vendit, transporti i nxënësve çka?

Zize Bujupi, Menaxher e Zyrës së prokurimit - vërejtjet e z. Elshanit së zyra r prokurimit punon në bazë të dëshirës së menaxheri së prokurimit i tregoj se kjo zyre punonë në bazë të ligjit për prokurimin publik dhe është njëra ndër komunat më të mira në Kosovë, në 2017 e kemi pasur vetëm një ankesë të dorëzuar në ASHP dhe ajo prape ka ardhur në favorin e autoritetit kontraktues e ka përkrah mendimin e Komisionit për vlerësim. Nuk janë punë të zyrës së prokurimit a kanë përfunduar punët apo jo. Zyra e prokurimit punën e saj e përfundon momentin e nënshkrimit të kontratës për implementim merret njësia kërkuese, sqaron që thanë dy herë është përsëritur hartimi i projekteve 70 mijë dhe 20 mijë, 70 mishi është hartim projekte 20 mishi është konkurs projektsh janë dy aktivitete të dalluara të konkursi i projektimit paguhet ideja të hartimi i projektit paguhet çmimi. Arbeni nuk e di çfarë raporti tjetër donë ky është raporti që e bën zyra e prokurimit kontratat e nënshkruara janë. Muhamet Ukaj ankohet që ka mungesa letre dhe toneri nëpër shkolla, kontrata për letër është që dy vite funksionale është nga niveli qendror jemi edhe ne duke e zbatuar sepse është Urdhëresa nga Qeveria, për tonerë është funksionale nuk e di pse është mungesa tyre. Ajshe Metaj sa i përketë pyetjes tuaj këto përgjigje duhet ti merrni nga drejtorati i arsimit, dhe shërbimet publike. Për udhëtimin e nxënësve kemi kontrata, shpija janë ndërtuar 10, rrethoja në shkollë është pjesa mbrapa shkollës Haxhi Zeka në Istog.

Arif Elshani, IQ - në e kemi një drejtor të prokurimit këtu dhe del e thotë 3 fjalë e thotë e thash, ankesa nuk ka pasur jo vetëm të ju por të shumica se tenderin e fiton ma i liri dhe zakonisht. Nëse ju si drejtoreshë nuk e menaxhoni kontratën deri në fund lexojeni ligjin e prokurimit çka thotë t'i jepte menaxheri i kontratës shefi yt është Kryetari por ti bën çka të konvenon ty, çka është bërë në bjeshkë, çka është bë me memorialin Ibrahim Rugova, ti buxhetin po e keqpërdor maksimalisht me një grup, po të them publikisht që një ditë vin përfundimet çka ke bë me memorialin Ibrahim Rugova sa para janë harxhuar t'i jepte nënshkruese e kontratës tash donë edhe 350 mijë a e keni përzgjedhur kontraktuesin.

Zize Bujupi - z. Elshani po me vjen keq që flisni pak më emocione për fjalën e dhen duhet me dhanë përgjegjësi, zyra e prokurimit është përgjegjëse deri ditën e nënshkrimit të kontratës merreni lexonte ligjin për menaxhimin e kontratës është menaxheri i projektit dhe kompania mbikëqyrës. Në punojmë në baza ligjore.

Muhamet Ukaj, AAK - jam menaxher i shkollës me drejtorin i kemi dorëzuar në drejtorët kërkesat por nuk e di pse duhet aso procedurash në mënyre që me u dorëzuar kërkesat në komunë e jo si me herët që e kishim mundësin me shku drejtë përsedrejt me marr material të nevojshëm.

Zize Bujupi - materiali shpenzues zotëron niveli qendrorë.

Ajshe Metaj, AAK - nuk ju drejtova me objektivizmit vetëm se i pash këtu kontratat dhe me interesojnë rreth atyre projekteve për deri sa janë këtu duhet dikush me më sqaruar përndryshe kush është kompetent merren tjerët njëzet me ato kompetenca.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë ne piken e radhës.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Rishikimi të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,

Hysni Maxharraj, drejtor për buxhet dhe financa – prezantoi dhe sqaron Rishikimi të Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba.

Kuvendi komunal më 15 vota për, dhe 4 abstenime vendosi:

Që Rishikimi i Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,

Miraton me shumicë votash.

Të pranishëm në sall ishin 19 anëtar të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me shtatë e gjashtë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP “Stacioni i Autobusëve” në Istog;

Arif Elshani, IQ - e përgëzoj Enverin ja paska pas vleftë që ja kundërshtim planin e sot i ka bërë 3 faqe pyete që sa muaj nuk kanë marr rroga ata punëtor dhe ku i ki planifiku paret, aj Stacion i Autobusëve pa parë nuk funksionon gjani parët unë i

propozova do mjetë me i marr të projektet që i ka marr ajo kompania boll çka janë 30 mijë euro me i hekë, gjani parët ose shitje atë vend është qendër e mirë me ndërtua ndonjë banesa apo ndërtesa boni diçka, ata punëtor nuk kanë marr paga që një vit , ju pyesë të vizave kush kish punua një vit pa paga moni së është gjynah gjë i parët mos me bini letra. Propozon që të gjinden parët nga buxheti i kryetarit me u hekë nga do projekte nga ato që shkojnë në bjeshkë, 60 mijë euro atyre duhet me jua siguruar ekzistencën dhe me jua dhen mundësin me punu këto letra janë të mira por duhet me jua siguru parët komuna ka bollë për me i keqpërdor sa shush.

Arben Kabashi, PDK - përshëndet Enverin që na ka dëgjuar një pjesë të madhe të rekomandimeve që e kemi bërë në mbledhjen e kaluar, ndërsa dokumenti ka nevojë për plotësime shtesë ftoj drejtimin që këtë temë mos me pas me tendencë ose si personale të kontribuojë bashkërisht për sanimin e gjendjes në Stacionin e Autobusëve kuptoj që je fillestar si drejtor, plani ka nevojë për ndërhyrje objektivi i parë kthimi i tarifave me vlerën paraprake është mirë që veprimi të parashihet të ndërmerret tash në muajin korrik mangësia themelohet se nuk e dimi saktësisht sa mjete ka kryer veprim dhe si i tillë mbetet veç objektivi i vendosur po me duket paushall ose rezultati në fund 50- 50 në muajin korrik drejtori ka parapare një subvencion, sa është shuma që me subvencionu Stacionin e Autobusëve dhe ku kemi mirë marr mjetet nga cila kategori ku ka me i quajtur këto mjet a për rrugë a për staf apo për mirëmbajtje të dihet, sa do të jetë rezultati afatshkurtër i këtij subvencionimi dhe a ka nevojë që në periudhe afatshkurtër me pas subvencionet shtesë. A është mbajtur takimi në transportin publike nëse është mbajtur çka ka dal nga aj takim? Këtu po folim për një gjendje emergjente të objektivi 4 është dashur të jetë 2. të objektivi 5 këtë pikë kisha thënë me parapare në një periudhe strikte raportim para Asamblesë komunale në objektivin shtatë veprim i mirë është me shpall tender me një kompani funksionale të auditimit. Të duhet saktë raporti i auditimit dhe kostoja.

Propozon të ngritët një komision intervistuesi i kandidatëve në pozitën e inspektorit pse mos të jetë komisioni nga anëtarët e asamblesë. Për shkak se në pozitë kyçe nuk po i marrin përgjegjësit dhe kompania po e pësojnë. Këto propozime të hedhen në votim ose me pëlqimin e juaj.

Naim Behlulin, LDK - e për gëzoj drejtorin për planin e shkëlqyer shpresoj se zbatohet, a funksionon bordi dhe kush janë ata persona emrat e tyre, a punon aj bord nëse nuk punon të shkarkohet.

Zenel Shatri, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, është një plan i mirë, por disa vende janë pak mangu për shembull subvencionimi vlera nuk është thënë, ndërsa kthimi i tarifave në kemi biseduar edhe në komitet një herë nuk bëhet fjalë nuk do ta kthejmë tarifat sepse me këto tarifa që janë nuk po mund ti shtim autobusët në Stacion. Punëtorët po punojnë pa paga kjo është e vështirë. Pyetën deri ku ka ardhur procedura për emërimin e inspektorit.

Mirushë Sadikaj, PDK - në këtë plan të veprimit që kemi duhet ta miratojmë dhe për ta miratuar duhet të i dimi planin e shpenzimeve cilat janë shpenzimet çka po miratojmë shpenzimet të përcaktohen problem kryesor është zgjedhja e inspektorit. Për subvencionet të shikohet gjendja.

Nexhmedin Balaj, AAK - a e ka ndërmend të funksionon Stacioni a jo nëse po të funksionoj si në të gjitha Kosovën.

Eliot Kukiqi, AAK - atë ditë në KPF e pyetëm drejtorin pse ky planë ka ardhur pa shuma thatë i kemi bë dy dhe do jua dërgojmë me shifra por prape por s'ka ndonjë ndryshim tabela është e zbrazët.

Enver Rugova, drejtor i shërbimeve publike, bënë prezantimin dhe sqarimin e Planit të veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP "Stacioni i Autobusëve" në Istog.

Arif Elshani, IQ - propozon që për stacion të autobusëve në fazën e parë të sigurohen 30 mijë euro nga buxheti i komunës dhe pas 6 mujorin edhe 20 mijë euro 50bmijë euro për ekzistence. Pa parë s'kemi pse miratojmë.

Zenel Shatri, LDK - nuk kisha caktu shumë pasi që nuk dihet sa parë na duhen por jam për me subvencionuar dhe me ndihmuar sa të kemi mundësi dhe via buxhetore.

Selajdin Bytyqi, LDK - përshëndeti të gjithë të pranishmit, në duhet ta ndihmojnë Stacioni e Autobusëve. Plani i veprimit lë të miratohet si plan në korrik e kemi raportin 6 mujorë në kuadër të asaj mund të gjendet diçka nga mjetet për ridistinin një shumë tu dedikohet atyre, ta miratojë strategjinë.

Kuvendi komunal më 14 vota për, 3 kundër dhe 1 Haki Podrimaj abstenime vendosi:

Që Planin e veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP "Stacioni i Autobusëve" në Istog

Miraton me shumicë votash, me mundësi subvencionimi.

19 anëtar prezent

Kryesuesi – Ndërsa lidhur me piken e 4 Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian, për vitin 2017 -2021, e kalova me herëte për shkake se konsideroj edhe pse është fut si pikë e rendit të ditës përshkakë të shfrytëzimit edhe të disa procedurave për shqyrtimin dhe analizimin e këtijë plani, propozoj kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:05.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

15

Procesverbali



**Kryesues,
Qaush Balaj**